




Pranim / Dorezuar / Priljean / Prilato / Received / Delivered	17-05-2022	2	with good proof
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org / Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No.	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKDMSHCK	2864/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.396/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2049/202 të datës 14.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.790/2021 të datës 08.09.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me prokurë e përfaqëson avokati me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës/ kompensim i koeficientit*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 17.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.790/2021 e datës 08.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Ferizajt, përmes përfaqësuesit me autorizim më datë 08.09.2021 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 4542/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë të datës 27.07.2021 të Menaxheres së Personalit të Komunës së Ferizajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.09.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Ferizajt, ndërsa kjo e fundit me datë 23.09.2021 ka dorëzuar dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Njoftimit me numër protokolli 5148/2021 të datës 22.10.2021, ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosje se ankesës A.nr.790/2021 të datës 08.09.2021 duke udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 14.04.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.2049/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit tani ankuesi, ka anuluar njoftimin e datës 22.10.2021 të Këshillit dhe ka obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.790/2021 të datës 08.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4542/2021 të datës 08.09.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër A.nr.2049/2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 19.04.2022; Fletkthesën e datës 28.10.2021; Njoftimin me numër protokolli 5148/2021 i datës 22.10.2021; Fletkthesën e datës 17.09.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.09.2021; Autorizimin e datës 18.06.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 27.07.2021; Kërkesën e datës 21.06.2021; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 21.06.2021; Kërkesën e përsëritur e datës 26.07.2021; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 26.07.2021; Ankesën për komisionin për ankesa dhe parashtresa në Komunën e Ferizajt i datës 29.07.2021; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 29.07.2021; Vendimin me numër 01nr.145/17 i datës 14.04.2017 për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil në vend tjetër të punës brenda institucionit; Listën e pagave për muajin 01.05.2021 deri 31.05.2021; Listën pagave për muajin 01.04.2021 deri 30.04.2021; Formularin e të dhënave për listën e pagave i datës 06.10.2017; Kërkesën për rivlerësimin e titullit të punës për Shërbyesin Civil i datës 07.03.2018; Plikon me numër R1741162 i datës 06.09.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 23.09.2021; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 21.09.2021; Formular i të dhënave për listën e pagave i datës 08.05.2017; Akt Emërimi i A.F. i datës 01.07.2016; E-mail nga C.Z. për F.V. i datës 26.04.2022; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 26.04.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 26.04.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i ankuesin i datës 20.01.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.790/2021 e datës 08.09.2021, e parashtruar nga ankuesi: **është e pabazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Ferizajt dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2016 është emëruar *Asistent Administrativ* në Njësinë për Shërbime të Përbashkëta. Me Vendimin me numër 01.nr.145/17 të datës 14.04.2017 të Kryetarit të Komunës, ankuesi është transferuar përkohësisht nga pozita Asistent administrativ në pozitën Inspektor Komunal në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mjedis, duke filluar prej datës 18.04.2017 deri në zgjedhjen e inspektorit komunal përmes konkursit të jashtëm.

Ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 21.06.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 01-120/04-0061423/21 adresuar Kabinetit të Kryetari të Komunës së Ferizajt, për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës nga pesë (5) në gjashtë (6), prej datës 14.04.2017. Pas heshtjes se organit të punësimit, ankuesi serish me datë 26.07.2021 parashtron kërkesë pranë organit të punësimit duke u bazuar në qëllimin dhe bazën e njëjtë.



Në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 26.07.2021, Menaxherja e Personelit të Komunës së Ferizajt me shkresën e datës 27.07.2021 ka njoftuar ankuesin se: *"Zyra e personelit me datë 01.05.2017 ka përcjell Vendimin 01 Nr.145/2017 të datës 14.04.2017 së bashku me formularin për ndryshimin e koeficientit në Ministrinë e Administratës Publike, mirëpo që kërkesa nuk është realizuar nga ana e MAP, prapë me datën 01.10.2017 Zyra e personelit ka përsëritur kërkesën në MAP për ndryshimin e koeficientit mirëpo nuk është realizuar.* Ankuesi kundër kësaj përgjigje ka ushtruar ankesë me datë 29.07.2021 në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës në Komunën e Ferizajt, ndërsa datë 08.09.2021 parashtron ankesë me bazë dhe qëllim po të njëjtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që ti bëhet diferenca e pagesës prej koeficientit pesë (5) në gjashtë (6) prej datës 14.04.2017 e deri më sot, sepse është dëmtuar në të ardhura personale pa fajin e tij dhe se koleget e tij në pozitën e inspektorit komunal paguhen me koeficient gjashtë (6) të pagës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*. Ndërlidhur me këtë Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, konkretisht neni 3 parasheh se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...* dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se sipas Vendimit 01.nr.145/17 të datës 14.04.2017, ankuesi është transferuar vetëm përkohësisht nga pozita e asistentit administrativ në pozitën Inspektor Komunal dhe si rrjedhojë bazuar në nenin 28 të Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil lidhur me nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr.06/22012 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *.Transferimi i përkohshëm mund të zgjatë deri në dymbëdhjetë (12) muaj... nëpunësi civil mund të transferohet në mënyrë të përkohshëm në një vend tjetër punë për ushtrimin e funksioneve të njëjta, ose të ndryshme në të njëjtën kategori funksionale, gradë dhe hap të pagës....Pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitë paraprak,*Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm nuk nënkupton caktim/apo sistemim të përhershëm pasi që me kalimin e periudhës së transferimit të përkohshme që nuk mund të jetë më shumë se dymbëdhjetë muaj, nëpunësi i transferuar duhet të kthehet në vendin paraprak të punës. Andaj, meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë akt tjetër administrativ të organit të punësimit përmes të cilës ankuesi i është njohur pozita e inspektorit komunal bazuar në procedurat e avancimit apo sistemimit të përhershëm, kështu që Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor për pagesë të diferencës së koeficientit të pagës nga 5 në 6 është i pa bazuar.

Po ashtu, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit që ti behët kompensimi retroaktiv nga data 14.04.2017 i dallimit të koeficientit për pozitën e punës inspektor komunal, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave e aplikueshme në kohën e nxjerrjes se Vendimit 01.nr.145/17 të datës 14.04.2017 mbi bazën e të cilit ankuesi mbështetë pretendimet ankimore, përkatësisht sipas nenit 4 paragrafi 1 më të cilin përcaktohet se: *Nëpunësit civil kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës,* Kolegji konstatoi se ankesa lidhur me këtë pretendim ankimor është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të

Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili parasheh se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, respektivisht në rastin konkret vendimi 01.nr.145/17 për transferimin e përkohshëm të ankuesit është nxjerrë me datë 14.04.2017, ndërsa ankuesja parashtron ankesë me datë 08.09.2021, gjegjësisht pas katër (4) vitesh.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.396/2022

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

